



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.106/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativa Për Progres (INPO), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të vënies së posterit në vend publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Iniciativës për Progres (INPO)

Arsyetim

PZAP-i, me datën 02.06.2014 ka pranuar një ankesë nga Iniciativa për Progres (INPO) në të cilën thekson se nga procesi i monitorimit të aktiviteteve të partive politike gjatë fushatës zgjedhore të këtyre ditëve me shqetësim ka vërejtur se në qytetin e Ferizajit partitë politike nuk po i respektojnë dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të përcaktuara me Kodin e Mirësjelljes në nenin 33 ku specifikohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore. INPO ka shtuar se përmes një konference për Media ka reaguar kundër mbulimit të simbolit të “Kamerierit” në qendër të qytetit me një poster të kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Ankuesi konsideron se mbulimi i emblemës së “Kamerierit” me materiale propaganduese zgjedhore përbën cenim të identitetit kulturor të qytetit, i cili identifikohet me këtë emblemë. Parashtruesi i ankesës thekson se posterit i vendosur mbi simbolin e qytetit të Ferizajit është i z.Adem Salihaj nga radhët e subjektit politik LDK. Ankuesi si dëshmi ka bashkangjitur fotografën e objektit ku u vendosur posterit i kandidatit nga radhët e LDK-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe neni 122 paragrafi 1 pika a) i LZP-së, subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur

me ankesën më datën 03.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 04.06.2014 në ora 09:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga LDK, në të cilën thekson se ankesa e INPO-së nuk ka bazë ligjore për faktin se me asnjë dokument të ndonjë organi zyrtar nuk është përcaktuar ose cilësuar “Kamarieri” si vlerë kulturore, identitet kulturor i qytetit apo emblemë e qytetit. Objekti në të cilën është vendosur është objekt privat-Hotel “ Lyboteni” quhej dhe se vendosja e posterit është lejuar nga pronari i këtij hoteli. Përgjigjes në ankesë LDK ia ka bashkangjitur deklaratën e pronarit të hotelit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të INPO-së lidhur me vendosjen e posterit të kandidatit për deputet nga radhët e LDK-së mbi të ashtuquajturën emblemë e qytetit të Ferizajit nuk qëndrojnë sepse nuk ka prova të argumentuara lidhur me atë se “Kamarieri” është e mbrojtur me ligj apo ndonjë rregull si emblemë qyteti apo ndonjë shenjë domethënëse-identifikuese për qytetin e Ferizajit. Nga kërkesa për përgjigje me numër Anr.106-2 në ankesë dhe urdhër për të ndërmarrë masa përmisuese dhe deklarata e pronarit të objektit konstatojmë se objekti në fjalë është pronë private dhe se për vendosjen e posterit të kandidatit Adem Salihaj ekziston një marrëveshje në mes pronarit dhe personit në fjalë.

Andaj PZAP-i, lidhur me pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe i pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 106/2014 më datën 04.06.2014.



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjopa e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*